



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: DHSK-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 25 tetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën për Leje për Apel ndaj “Vendimit mbi Mocionet që Ngrënë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve”

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenin 45 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 77 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 31 gusht 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi “Vendimin mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve (“Vendimi i Kundërshtuar”).²

2. Më 17 shtator 2021, pas miratimit të një shtyrjeje afati,³ Mbrojtja e Hashim Thaçit (“z. Thaçi” dhe “Mbrojtja e Thaçit”) dhe Mbrojtja e Kadri Veselit (“z. Veseli” dhe “Mbrojtja e Veselit”) parashtruan kërkesa (përkatësisht, “Kërkesa e Thaçit” dhe “Kërkesa e Veselit”) me të cilat kërkonin leje për apel në lidhje me pika që kanë të bëjnë me Vendimin e Kundërshtuar.⁴

3. Më 24 shtator 2021, me kërkesë të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”),⁵ Gjykatësi i Procedurës Paraprake i miratoi ZPS-së shtyrje të afatit deri më 6 tetor 2021

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00450, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve*, 31 gusht 2021, publik.

³ KSC-BC-2020-06, F00458, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Përmbledhës mbi Kërkesat për Zgjatje të Afatit*, 6 shtator 2021, publik, para. 11.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00473, Mbrojtja e Thaçit, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të “Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve”*, 17 shtator 2021, publike; F00474, Mbrojtja e Veselit, *Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin që Ngre Kundërshtime për Juridiksionin mbi Bazën e Shkeljes së Kushtetutës (KSC-BC-2020-06/F00450)*, 17 shtator 2021, publike. Më 18 tetor 2021, u protokollua një version i korrigjuar i Kërkesës së Veselit F00474/COR.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00488, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë për Zgjatjen e Afatit për t’iu Përgjigjur Kërkesave për Leje për Apelim të Vendimit KSC-BC-2020-06/F00450*, 24 shtator 2021, publike.

për parashtrimin e përgjigjeve ndaj Kërkesës së Thaçit dhe Kërkesës së Veselit dhe miratoi shtyrje të afatit për kundërpërgjigjet deri në 18 tetor 2021.⁶

4. Më 6 tetor 2021, ZPS-ja iu përgjigj Kërkesës së Thaçit (“Përgjigjja ndaj Kërkesës së Thaçit”)⁷ dhe Kërkesës së Veselit (“Përgjigjja ndaj Kërkesës së Veselit”).⁸

5. Më 18 tetor 2021, Mbrojtja e Veselit dhe Mbrojtja e Thaçit parashtruan kundërpërgjigjet (përkatësisht, “Kundërpërgjigjja e Veselit” dhe “Kundërpërgjigjja e Thaçit”).⁹

II. PARASHTRIMET

6. Mbrojtja e Thaçit kërkon leje për të apeluar Vendimin e Kontestuar për këto tetë pika:

- (1) Nëse konstatimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake që mandati kohor i DHSK-së dhe ZPS-së nuk ka përfunduar cenohet nga mosshqyrtimi, ose mosdhënia e një arsytimi, apo e një arsytimi të mjaftueshëm, në lidhje me (i) synimin legjislativ të Kuvendit; (ii) amendamentin nr. 26 të propozuar të Kushtetutës; (iii) njoftimin sipas nenit 162(14) që është i zbatueshëm për mandatin kohor minimal; dhe (iv) që bartja e sovranitetit sipas nenit 20 të Kushtetutës nuk duhet të jetë e pakufizuar, e pasigurt dhe e njëanshme (“Pika I”);

⁶ KSC-BC-2020-06, F00490, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit për t’iu Përgjigjur Kërkesave për Leje për Apelim të Vendimit KSC-BC-2020-06/F00450 (“Urdhri për Shtyrjen e Afateve për Përgjigjet dhe Kundërpërgjigjet”), 24 shtator 2021, publik, para. 11.*

⁷ KSC-BC-2020-06, F00506, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Hashim Thaçit për Leje për Apelim të “Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve, 6 tetor 2021, publike.*

⁸ KSC-BC-2020-06, F00507, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj “Kërkesës së Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin që Ngre Kundërshtime për Juridiksionin mbi Bazën e Shkeljes së Kushtetutës”, 6 tetor 2021, publike.*

⁹ KSC-BC-2020-06, F00530, Mbrojtja e Veselit, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjes së ZPS-së ndaj Parashtrimit të Protokolluar KSC-BC-2020-06/F00474, 18 tetor 2021, publike; F00532, Mbrojtja e Thaçit, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj “Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Kërkesës së Hashim Thaçit për Leje për Apelim të “Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve”, 18 tetor 2021, publike.*

- (2) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur përfundoi se për aspektin e mandatit kohor të DHSK-së ishte “marrë vendim nga DHSGJK-ja”, pa dhënë arsytim ose të paktën arsytim të mjaftueshëm, dhe në mospajtim me nenet 113(7) dhe 144(3) të Kushtetutës, të cilat Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk i mori aspak parasysh (“Pika II”);
- (3) Lidhur me pikën mbi ekzistencën ose mungesën e bazës ligjore ose kushtetuese të hetimit të ZPS-së, nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që konstatimin e tij e bazoi në mënyrë të gabuar në argumentin se neni 159(1) i KPPK-së nuk ishte përfshirë shprehimisht në Ligjin për DHSK-së, në vend që të orientohej siç duhej prej aspektit të zbatueshmërisë së KPPK-së kur nuk shprehen Ligji dhe Rregullorja e DHSK-së, si dhe që shpërfilli argumentet e Mbrojtjes në lidhje me Shkëmbimin e Letrave (“Pika III”);
- (4) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur thjesht rrëzoi argumentet e Mbrojtjes se Ligji i DHSK-së themelon një “gjykatë të jashtëzakonshme”, duke u mbështetur në një konstatim të mëhershëm se DHSK-ja është e themeluar me ligj, pa shqyrtuar thelbin e argumenteve të Mbrojtjes (“Pika IV”);
- (5) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që nuk shqyrtoi ose nuk dha arsytim të mjaftueshëm në lidhje me pikat e ngritura nga Mbrojtja sa i takon të drejtës së z. Thaçi për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, duke u mbështetur gabimisht në jurisprudencën e pazbatueshme të GJEDNJ-së, si dhe që nuk mori aspak parasysh nëse “të marra bashkërisht, këto elemente çojnë në përfundimin e pashmangshëm se DHSK-ja për nga struktura nuk përmbush kriteret e nenit 6(1) të KEDNJ-së” (“Pika V”);
- (6) Nëse ishte e mundshme për Gjykatësin e Procedurës Paraprake si gjykues i arsyeshëm të nxirrte konstatimin se qëllimi i kriterit të pavarësisë dhe paanësisë nuk është të imponojë ndërhyrje në punën e Prokurorit të Specializuar, sidomos duke pasur parasysh se kjo bie ndesh me nenet 109(1) dhe (2) të Kushtetutës (“Pika VI”);
- (7) Sa i takon të drejtës për t’u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme, nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur konstatoi se periudha përkatëse ka filluar jo më parë se 17 nëntori 2019, duke u mbështetur gabimisht në një interpretim kufizues të jurisprudencës përkatëse të GJEDNJ-së (“Pika VII”); dhe
- (8) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi në vlerësimin e shkeljes së parimit të prezumimit të pafajësisë së z. Thaçi në kontekstin e vetë Raportit Marti përmes mosshqyrtimit të argumenteve të Mbrojtjes se shkelja buron nga përcaktimi i pozicionit të DHSK-së në kuadër të një

raporti që dënon të akuzuarit dhe nga “bekimi” që DHSK-ja dhe ZPS-ja i japin Raportit (“Pika VIII”).¹⁰

7. Mbrojtja e Veselit kërkon leje për të apeluar Vendimin e Kontestuar për këtë pikë:

Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur nuk shqyrtoi nëse korniza e së drejtës materiale e Gjykatës shkakton pabarazi sipas ligjit në shkelje të neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës, çka e bën Gjykatën “të paligjshme” në kuptim të nenit 103(7) (“Pika IX”).¹¹

8. ZPS-ja përgjigjet se Kërkesa e Thaçit duhet të refuzohet sepse nuk përmbush kushtet për leje për apel dhe nuk vërteton se ndonjëra prej tetë pikave meriton apelim në këtë fazë të procedimit.¹² ZPS-ja përgjigjet më tej se Kërkesa e Veselit duhet rrëzuar sepse shpërfill pjesët përkatëse të Vendimit të Kundërshtuar ose nuk buron prej tij.¹³

9. Mbrojtja e Veselit kundërpërgjigjet se kërkesa e saj duhet miratuar.¹⁴

10. Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se Përgjigjja ndaj Kërkesës së Thaçit e kalon numrin e lejuar të fjalëve dhe rrjedhimisht duhet të refuzohet “ose të ridorëzohet menjëherë, shoqëruar me të drejtën e Mbrojtjes për një tjetër kundërpërgjigje.”¹⁵

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

11. Në pajtim me nenin 45 të Ligjit, Paneli i Gjykatës së Apelit shqyrton apele të ndërmjetme të paraqitura nga i akuzuari ose nga Prokurori i Specializuar në pajtim me Ligjin dhe Rregulloren. Për apelet e ndërmjetme, përveç atyre që janë vetvetiu të lejueshëm, duhet të miratohet leje prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake ose Trupit Gjykues, mbi bazën se kanë të bëjnë me një çështje që do të ndikonte ndjeshëm në

¹⁰ Kërkesa e Thaçit, para. 10.

¹¹ Kërkesa e Veselit, para. 2.

¹² Përgjigjja ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 1, 43.

¹³ Përgjigjja ndaj Kërkesës së Veselit, para. 1, 10.

¹⁴ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 8.

¹⁵ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 1.

kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose në rezultatin e gjykimit dhe për të cilën, sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake ose të Trupit Gjykses, një vendim i menjëhershëm i Panelit të Gjykatës së Apelit mund të avancojë thelbësisht procesin gjyqësor.

12. Rregulla 77(2) e Rregullores parashikon gjithashtu se Paneli miraton lejen në qoftë se vendimi lidhet me një çështje që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit, ndër të tjera, në qoftë se mjetet e përshtatshme juridike praktikisht nuk do të mund të miratoheshin pas mbylljes së çështjes që gjykohet dhe për të cilën një vendim i menjëhershëm i Panelit të Gjykatës së Apelit mund të avancojë thelbësisht procesin gjyqësor.

IV. DISKUTIM

A. NUMRI I LEJUAR I FJALËVE I PËRGJIGJES SË ZPS-SË

13. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, megjithëse në përgjithësi për përgjigjet numri i lejuar i fjalëve është 6.000 fjalë, përgjigjet ndaj një kërkesë për leje nuk mund të jenë më shumë se 3.000 fjalë.¹⁶ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Thaçit është 4.104 fjalë. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i rikujton ZPS-së të ndjekë në të ardhshmen udhëzuesin e punës dhe të kontrollojë numrin e fjalëve të përgjigjeve të saj ndaj çdo kërkesë për leje. Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mendon se Mbrojtja e Thaçit është cenuar nga tejkalimi i numrit të lejuar të fjalëve të parashtrimit të protokolluar të ZPS-së meqë ky tejkalim nuk ishte i tepruar. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu vlerëson se nëse kishte nevojë ta plotësonte kundërpërgjigjen për shkak të gjatësisë së parashtrimit të ZPS-së, Mbrojtja e Thaçit mund të kishte kërkuar shtim të numrit

¹⁶ KSC-BD-15, Udhëzuesi i Punës i Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019, publik, nenet 41 dhe 43.

të lejuar të fjalëve *përpara* se të protokollonte kundërpërgjigjen e vet, sidomos duke marrë parasysh që Mbrojtjes së Thaçit iu dha një javë shtesë për parashtrimin e kundërpërgjigjes së vet.¹⁷

14. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake refuzon kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për rrëzimin e Përgjigjes së ZPS-së ndaj Kërkesës së Thaçit dhe kërkesën e saj për të parashtruar një tjetër kundërpërgjigje.

B. STANDARDI LIGJOR

15. E drejta për apel lind vetëm nëse paneli është i mendimit se është përmbushur standardi për lejen i parashikuar në nenin 45(2) të Ligjit dhe në rregullën 77(2) të Rregullores.¹⁸ Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton interpretimin e këtyre dispozitave të përshkruar me hollësi më parë.¹⁹

16. Duke pasur në vëmendje natyrën e kufizuar të këtij mjetei juridik, zbatohen kriteret specifike të mëposhtme:

- (1) nëse çështja e ngritur përbën “një pikë të apelueshme”;
- (2) nëse pika në fjalë do të ndikonte ndjeshëm:
 - i. në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose
 - ii. në rezultatin e gjykimit; dhe

¹⁷ Urdhri për Shtyrjen e Afateve për Përgjigjet dhe Kundërpërgjigjet, para. 11.

¹⁸ *Shih edhe* KSC-2020-06, F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apel* (“Vendimi mbi Lejen për Apel të Thaçit”), 11 janar 2021, publik, para. 9. *Ngjashëm*, ICC/GJPN, *Situation in the Democratic Republic of the Congo*, ICC-01/04-168, Judgment on the Prosecutor’s Application for Extraordinary Review of Pre-Trial Chamber I’s 31 March 2006 Decision Denying Leave to Appeal, 13 July 2006, para. 20.

¹⁹ *Shih* Vendimi mbi Lejen për Apel të Thaçit, para. 9-17.

(3) nëse, sipas mendimit të Panelit, një vendim i menjëhershëm i Dhomës së Apelit mund të avancojë thelbësisht procesin gjyqësor.²⁰

C. PIKAT

1. Pika I

17. Mbrojtja e Thaçit argumenton se, nëse ka përfunduar mandati kohor, atëherë procesi nuk ka asnjë bazë ligjore dhe kushtetuese dhe nuk mund të vazhdojë, çka pamundëson kryerjen e një procesi të drejtë dhe të shpejtë dhe ndikon ndjeshëm në rezultatin e tij.²¹

18. ZPS-ja përgjigjet se, në lidhje me Pikën I, Mbrojtja e Thaçit: (i) nuk identifikon saktësisht burimin e gabimit apo nuk shpjegon se si gabimi i pretenduar ndikon në Vendimin e Kundërshtuar; (ii) keqinterpretton Vendimin e Kundërshtuar; dhe (iii) nuk shpjegon se si referimi i kësaj pike për shqyrtim para një paneli të Gjykatës së Apelit do ta avanconte thelbësisht procesin po të kemi parasysh vendimet me fuqi detyruese të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (“DHSGJK”) mbi këtë pikë.²²

19. Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ka për detyrë të japë një vendim të arsyetuar dhe se mosdhënia e arsyeve të tilla përbën gabim ligjor.²³

20. Sa i takon Pikës I dhe pretendimit të Mbrojtjes së Thaçit se në Vendimin e Kundërshtuar nuk u shqyrtuan ose nuk u dha arsyetim ligjor për secilin prej argumenteve të saj, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se të gjitha argumentet

²⁰ *Shih* Vendimi mbi Lejen për Apel të Thaçit, para. 10.

²¹ Kërkesa e Thaçit, para. 14.

²² Përgjigjja ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 15-17.

²³ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 3-6.

thelbësore²⁴ të z. Thaçi u morën parasyssh.²⁵ Ngritja e të njëjtave argumente tani thjesht pasqyron mospajtimin e Mbrojtjes së Thaçit me konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe mbështetet në një keqinterpretim të Vendimit të Kundërshtuar. Që një pikë të jetë e apelueshme, apeluesi duhet të shprehë qartë pikat e veçanta që shtron për zgjidhje para Gjykatës së Apelit.²⁶ Këtu, Mbrojtja e Thaçit vetëm sa përsërit argumente të paraqitura më parë para Gjykatësit të Procedurës Paraprake, pa e përcaktuar me saktësi gabimin e pretenduar në lidhje me cilindo prej konstatimeve të Gjykatësit të Procedurës Paraprake.²⁷ Gjithashtu, pika, ashtu si është formuluar, thjesht sa ngre pyetjen nëse përfundimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake “cenohet”, pa treguar se si nënpikat (i)-(iv), të renditura në Pikën I, do të çonin në një përfundim të kundërt nga ai i Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Pika I nuk përbën pikë të apelueshme dhe, për pasojë, nuk do ta vlerësojë pjesën tjetër të standardit ligjor.

21. Në përputhje me sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Pika I nuk përmbush standardin e autorizimit për apelim.

2. Pika II

22. Mbrojtja e Thaçit argumenton se, nëse ka përfunduar mandati kohor, atëherë procesi nuk ka asnjë bazë ligjore dhe kushtetuese dhe nuk mund të vazhdojë, çka

²⁴ *Shih, për shembull, ECtHR/GJEDNJ, Case of Van de Hurk v. the Netherlands, 16034/90, Judgment, 19 April 1994, para. 61 (“Neni 6 para. 1 [...] detyron gjykatat të japin arsye të tyre, por nuk mund të kuptohet se kërkon një përgjigje të hollësishme për çdo argument”); Case of Taxquet v Belgium [GC], 926/05, Judgment, 16 November 2010, para. 91 (“Megjithëse gjykatat nuk janë të detyruara të japin përgjigje të hollësishme për çdo argument të ngritur, duhet të dalë qartë nga vendimi se janë shqyrtuar pikat thelbësore të çështjes”).*

²⁵ Vendimi i Kundërshtuar, para. 61-68.

²⁶ Vendimi mbi Lejen për Apel të Thaçit, para. 11.

²⁷ KSC-BC-2020-06, F00216, Mbrojtja e z. Thaçi, *Mocion Paraprak për Rrëzimin e Aktakuzës për shkak të Mungesës së Juridiksionit* (“Mocioni i Thaçit mbi Mungesën e Juridiksionit”), 12 mars 2021, para. 44-52.

pamundëson kryerjen e një procesi të drejtë dhe të shpejtë dhe ndikon ndjeshëm në rezultatin e tij.²⁸

23. Sa i takon Pikës II, ZPS-ja përgjigjet se pika: (i) nuk është mjaftueshëm e saktë ose konkrete për të qenë pikë e apelueshme; (ii) keqinterpreton Vendimin e Kundërshtuar; dhe (iii) nuk do të ndikonte ndjeshëm në drejtësinë ose rezultatin e procesit sepse pretendohet vetëm se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhej të kishte dhënë arsyetim shtesë dhe nuk duhej t'u ishte referuar qëndrimeve të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("DHSGJK").²⁹

24. Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka detyrimin të japë vendim të arsyetuar dhe se mosdhënia e arsyeve të tilla përbën gabim ligjor.³⁰

25. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Mbrojtja e Thaçit paraqet një pikë të apelueshme që buron nga Vendimi i Kundërshtuar për aq sa pretendon se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur përfundoi se për aspektin e mandatit të Dhomave të Specializuara të Kosovës ("DHSK") ishte marrë vendim nga DHSGJK-ja.

26. Pika II ka të bëjë me të drejtën e të akuzuarve për t'u gjykuar nga një gjykatë e themeluar me ligj, e drejtë të cilën z. Thaçi ia jep neni 6(1) i Konventës (Evropiane) për Mbrojtjen e Të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("KEDNJ"). Një konstatim nëse DHSGJK-ja ka marrë vendim ose jo për mandatin e DHSK-së me gjasë do të parandalonte çdo debat juridik në të ardhmen lidhur me aspektin nëse DHSK-së i ka mbaruar ose jo mandati, çka ndikon ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit dhe siguron që procesi të mos vijojë në shkelje të të drejtave të të Akuzuarve. Për këto arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Pika II ndikon ndjeshëm

²⁸ Kërkesa e Thaçit, para. 14.

²⁹ Përgjigjja ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 19-21.

³⁰ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 3-6.

në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, siç parashikohet në nenin 45(2) të Ligjit dhe në rregullën 77(2) të Rregullores.

27. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon gjithashtu se një vendim me fuqi detyruese i Panelit të Gjykatës së Apelit mbi Pikën II do ta avancojë thelbësisht procesin, duke qenë se mandati kohor i DHSK-së është një pikë themelore që ka të bëjë me faktin nëse DHSK-ja ka bazën ligjore për të vazhduar, dhe është një pikë e cila, nëse nuk zgjidhet, do ta dëmtonte rezultatin e procesit gjyqësor.

28. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Pika II përmbush standardin e autorizimit dhe miraton leje për apelim të Pikës II.

3. Pika III

29. Në Pikën III, Mbrojtja e Thaçit kundërshton bazën ligjore dhe kushtetuese të hetimit të ZPS-së. Mbrojtja e Thaçit argumenton se, nëse ZPS-ja nuk do të kishte të drejtë të rihetonte, atëherë drejtësia, shpejtësia dhe rezultati i procesit do të ndikoheshin në mënyrë të ngjashme dhe të ndjeshme.³¹

30. ZPS-ja përgjigjet se Pika III nuk meriton leje për apelim sepse: (i) keqinterpreton Vendimin e Kundërshtuar; (ii) paraqet një pyetje hipotetike që nuk meriton leje për apel; dhe (iii) argumenton se i pasaktë ka qenë procesi i arritjes së përfundimit përkatës dhe jo rezultati i atij procesi.³²

³¹ Kërkesa e Thaçit, para. 14.

³² Përgjigjja ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 23-26.

31. Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që nuk shqyrtoi Shkëmbimin e Letrave³³ dhe se çdo supozim se i njëjti konstatim do të ishte arritur po të mos ishte bërë gabimi, është thjesht hamendësues.³⁴

32. Në lidhje me Shkëmbimin e Letrave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se ky argument është vetëm në mbështetje të parashtrimit kryesor të Mbrojtjes lidhur me zbatueshmërinë e nenit 159 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës ("KPPK").³⁵ Në fakt, kundërshtimi i Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me ligjshmërinë e hetimeve të ZPS-së përqendrohej në zbatueshmërinë e nenit 159 të KPPK-së. Duke qenë se zbatueshmëria e KPPK-së në kornizën ligjore të DHSK-së është ngritur më parë si pikë për të cilën është marrë vendim nga një panel i Gjykatës së Apelit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kjo pikë nuk do ta avanconte thelbësisht procesin.³⁶

33. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Pika III nuk e përmbush standardin e autorizimit për apelim.

4. Pika IV dhe Pika V

34. Mbrojtja e Thaçit argumenton se Ligji i DHSK-së themeloi një gjykatë të jashtëzakonshme, e cila nuk i përmbush garancitë e pavarësisë dhe paanësisë, duke pasur parasysh mungesën e legjislacionit të duhur për mbrojtjen e këtyre garancive.³⁷

³³ Shkëmbimi i letrave në vitin 2014 nga Presidentja e Kosovës dhe Përfaqësuesja e Lartë është ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës. *Shih* Ligji Nr. 04/L-274 për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, 23 prill 2014. Bashkërisht, këto letra quhen "Shkëmbimi i Letrave".

³⁴ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 7-8.

³⁵ Mocioni i Thaçit mbi Mungesën e Juridiksionit, para. 57.

³⁶ KSC-BC-2018-01, F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin ndaj "Vendimit mbi Kërkesën për Urdhër drejtuar Prokurorit të Specializuar për Pushimin e Hetimit kundër Driton Lajçit"*, 1 tetor 2021, publik, para. 2, 14-23.

³⁷ Kërkesa e Thaçit, para. 15.

35. ZPS-ja përgjigjet se Pika IV dhe Pika V nuk meritojnë leje për apel sepse: (i) keqinterpretojnë Vendimin e Kundërshtuar;³⁸ (ii) nuk janë mjaftueshëm të saktësuar;³⁹ dhe (iii) kërkojnë arsytim shtesë pa shpjeguar se si një arsyetim i tillë do të ndikonte ndjeshëm në drejtësinë ose rezultatin e procesit gjyqësor.⁴⁰

36. Në lidhje me Pikën IV, Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se dhënia e shpjegimeve të mëtejshme se si ka gabuar Gjykatësi i Procedurës Paraprake, për të cilat ngul këmbë ZPS-ja në Përgjigjen ndaj Kërkesës së Thaçit, do ta “transformonte procesin e autorizimit në një debat juridik mbi themelësinë.”⁴¹ Sa i takon Pikës V, Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ka për detyrë të japë vendim të arsyetuar dhe se mosdhënia e arsyeve të tilla përbën gabim ligjor.⁴²

37. Sa i takon Pikës IV, Vendimi i Kundërshtuar nuk u mbështet thjesht në konstatimin se DHSK-ja është e themeluar me ligj për të arritur në përfundimin se DHSK-ja nuk është gjykatë e jashtëzakonshme. Përkundrazi, në Vendimin e Kundërshtuar theksohet se “[p]asi arriti [...] në përfundimin se DHS[K]-ja është e themeluar me ligj dhe se pavarësia dhe paanësia e saj nuk mund të vihen në dyshim, as, ndër të tjera, nga procedurat e emërimit të gjykatësve e as nga fakti që DHS[K]-ja mbështetet në një ligj të veçantë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se pretendimi se DHS[K]-ja është *de facto* një gjykatë e jashtëzakonshme që funksionon në shkelje të nenit 103(7) të Kushtetutës nuk ka asnjë bazë”.⁴³ Konstatimi përkatës në Vendimin e Kundërshtuar faktikisht mbështetet në faktorë të tjerë nga themelimi i DHSK-së me ligj dhe, rrjedhimisht, Pika IV e keqinterpreton Vendimin e Kundërshtuar. Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Pika IV nuk përbën një pikë të apelueshme dhe, për pasojë, nuk do të vlerësojë pjesën tjetër të

³⁸ Përgjigjja ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 28, 32.

³⁹ Përgjigjja ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 29, 31.

⁴⁰ Përgjigjja ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 29, 33.

⁴¹ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 9-10.

⁴² Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 3-6.

⁴³ Vendimi i Kundërshtuar, para. 113.

standardit ligjor. Në përputhje me sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Pika IV nuk e përmbush standardin e autorizimit për apelim.

38. Sa i takon Pikës V, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se pjesë të kësaj pike, ashtu sikurse është formuluar, nuk janë të apelueshme sepse nuk janë mjaftueshmërisht të saktësuar. Mbrojtja e Thaçit nuk specifikon se cilave “pika të ngritura nga Mbrojtja” u referohet. Krahas kësaj, referimi i “jurisprudencës së pazbatueshme të [Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (“GJEDNJ”)]” është tepër i përgjithshëm duke qenë se nuk specifikohet jurisprudenca në fjalë apo konstatimi me të cilin ka lidhje. Kjo mungesë saktësie ndërlikohet më tej nga pretendimi i paqartë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake “nuk shqyrtoi ose nuk dha arsyetim të mjaftueshëm”.

39. Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se pjesa e fundit e Pikës V është një pikë që buron nga Vendimi i Kundërshtuar. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të zbatojë standardin e autorizimit në lidhje me pikën në vijim:

Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që mori parasysh se, të marra bashkërisht, elementet e DHSK-së të ngritura nga Mbrojtja e Thaçit çojnë në përfundimin se DHSK-ja për nga struktura nuk përmbush kriteret e nenit 6(1) të KEDNJ-së.

40. Pika V ka të bëjë me të drejtën e të Akuzuarve për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj, e drejtë të cilën z. Thaçi ia jep neni 6(1) i KEDNJ-së. Një zgjidhje e hershme e kësaj pike do ta thjeshtonte procesin dhe do ta avanconte të drejtën e z. Thaçi për t’u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme, siç parashikohet në nenin 21(4)(d) të Ligjit. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se zgjidhja e kësaj pike në shkallën e apelit do të parandalonte çdo debat juridik në të ardhmen dhe do të përcaktonte nëse, për nga struktura, DHSK-ja funksionon në

shkelje të të drejtave të të Akuzuarve sipas nenit 6(1) të KEDNJ-së. Për këto arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Pika V, e riformuluar, ndikon ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, siç parashikohet në nenin 45(2) të Ligjit dhe në rregullën 77(2) të Rregullores.

41. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton gjithashtu se një vendim me fuqi detyruese i Panelit të Gjykatës së Apelit në lidhje me pikën e riformuluar do ta avanconte thelbësisht procesin sepse aspekti nëse për nga struktura DHSK-ja funksionon në shkelje të nenit 6(1) të KEDNJ-së është një pikë kyçe për këtë proces, e cila, nëse nuk zgjidhet, do ta dëmtonte rezultatin e procesit gjyqësor.

42. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Pika V, siç është riformuluar në paragrafin 39, më lart, përmbush standardin e autorizimit dhe rrjedhimisht autorizon apelimin e Pikës V të riformuluar.

5. Pika VI

43. Mbrojtja e Thaçit argumenton se Pika VI identifikon gabime ligjore dhe arsyetimi në vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, të cilat medoemos ndikojnë ndjeshëm në drejtësinë dhe shpejtësinë e procesit gjyqësor, si edhe në rezultatin e tij.⁴⁴

44. ZPS-ja argumenton se Pika VI: (i) paraqet argumente të reja në lidhje me nenet 109(1) dhe (2) të Kushtetutës; (ii) e keqinterpreton përfundimin mbi të cilin Gjykatësi i Procedurës Paraprake bazoi vendimin; dhe (iii) kërkon arsyetim shtesë pa shpjeguar se si një arsyetim i tillë do të ndikonte ndjeshëm në drejtësinë ose rezultatin e procesit gjyqësor.⁴⁵

⁴⁴ Kërkesa e Thaçit, para. 15.

⁴⁵ Përgjigjja ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 35-36.

45. Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake paraqiti një qëndrim të ri dhe të papritur të cilin Gjykata e Apelit duhet lejuar ta shqyrtojë.⁴⁶

46. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se kjo pikë, ashtu siç është formuluar, nuk buron nga Vendimi i Kundërshtuar. Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk konstatoi se qëllimi i kriterit të pavarësisë dhe paanësisë nuk është të imponojë ndërhyrje në punën e Prokurorit të Specializuar. Pika përkatëse e paraqitur për shqyrtim para Gjykatësit të Procedurës Paraprake ishte pavarësia dhe paanësia e DHSK-së brenda kuptimit të nenit 6(1) të KEDNJ-së dhe pikërisht në lidhje me këtë pikë u bë më në fund edhe konstatimi.⁴⁷ Krahas kësaj, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja e Thaçit i paraqet në mënyrë të palejueshme argumentet e veta në lidhje me nenet 109(1) dhe (2) të Kushtetutës për herë të parë në kërkesën për leje për apel. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Pika VI nuk përbën pikë të apelueshme dhe për pasojë nuk do ta vlerësojë pjesën tjetër të standardit ligjor.

47. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Pika VI nuk e përmbush standardin e autorizimit për apelim.

6. Pika VII

48. Mbrojtja e Thaçit argumenton se, meqë Pika VII ka të bëjë me të drejtën për t'u gjykuar pa vonesë të panevojshme, nënkuptohet që rrjedhimisht do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, si edhe në rezultatin e çdo gjykimi të mëpasshëm.⁴⁸

49. ZPS-ja përgjigjet se Pika VII nuk meriton leje për apel sepse Mbrojtja e Thaçit nuk shpjegon se si interpretimi i jurisprudencës së GJEDNJ-së nga Gjykatësi i Procedurës

⁴⁶ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 11.

⁴⁷ Vendimi i Kundërshtuar, para. 108, 111.

⁴⁸ Kërkesa e Thaçit, para. 16.

Paraprake është i gabuar apo ndikon ndjeshëm në drejtësinë apo rezultatin e procesit gjyqësor.⁴⁹

50. Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se dhënia e shpjegimeve të mëtejshme se si ka gabuar Gjykatësi i Procedurës Paraprake, për të cilat ngul këmbë ZPS-ja në Përgjigjen ndaj Kërkesës së Thaçit, do ta “transformonte procesin e autorizimit në një debat juridik mbi themelësinë.”⁵⁰

51. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Pika VII është një pikë që buron nga Vendimi i Kundërshtuar sepse e drejta për t’u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme ishte një pikë e kontestuar. Kjo pikë ndikon ndjeshëm edhe në drejtësinë e procesit sepse lidhet drejtpërdrejt me të drejtën e z. Thaçi për t’u gjykuar pa vonesë të panevojshme, siç parashikohet në nenin 21(4)(d) të Ligjit. Ajo ndikon ndjeshëm edhe në kryerjen e shpejtë të procesit sepse zgjidhja në apel e kohëzgjatjes së periudhës përkatëse kundrejt së cilës do të matej e drejta për t’u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme, do të shmangte çdo debat juridik në lidhje me këtë aspekt në të ardhmen dhe do të siguronte që procesi të mos vijojë në shkelje të të drejtave të të Akuzuarve. Për këto arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Pika VII ndikon ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit gjyqësor, siç parashikohet në nenin 45(2) të Ligjit dhe në rregullën 77(2) të Rregullores.

52. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu vlerëson se një vendim me fuqi detyruese i Panelit të Gjykatës së Apelit lidhur me Pikën VII do ta avanconte thelbësisht procesin sepse do t’i informonte të gjitha palët për pikënisjen e njehsimit të kohës së arsyeshme dhe do të siguronte matjen e saktë të saj.

⁴⁹ Përgjigja ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 38.

⁵⁰ Kundërpërgjigja e Thaçit, para. 9-10.

53. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Pika VII përmbush standardin e autorizimit dhe autorizon apelimin e Pikës VII.

7. Pika VIII

54. Mbrojtja e Thaçit argumenton se VIII ka të bëjë me të drejtën për t'u prezumuar i pafajshëm dhe vetëkuptohet që rrjedhimisht do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, si edhe në rezultatin e çdo gjykimi të mëpasshëm.⁵¹

55. ZPS-ja përgjigjet se Pika VIII: (i) keqinterpreton Vendimin e Kundërshtuar; (ii) paraqet një pyetje abstrakte; dhe (iii) nuk ndikon ndjeshëm në drejtësinë apo rezultatin e procesit gjyqësor.⁵²

56. Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mori parasysh "bekimin" që vetë DHSK-ja dhe ZPS-ja i japin Raportit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Dok. 12462, të datës 7 janar 2011 ("Raporti Marti") dhe se duhet të autorizohet apelimi i kësaj pike sepse ajo ngre çështje themelore të drejtësisë.⁵³

57. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se pjesë të Pikës VIII, ashtu siç është formuluar nga Mbrojtja e Thaçit, nuk janë të apelueshme sepse e keqinterpretojnë Vendimin e Kundërshtuar. Në veçanti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se argumenti i Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me statusin e Raportit Marti si "Dokument Themelor" u shqyrtua shprehimisht në Vendimin e Kundërshtuar.⁵⁴ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do ta zbatojë standardin e autorizimit në lidhje me riformulimin e mëposhtëm të Pikës VIII:

⁵¹ Kërkesa e Thaçit, para. 16.

⁵² Përgjigjja ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 40-42.

⁵³ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 12.

⁵⁴ Vendimi i Kundërshtuar, para. 141.

Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur konstatoi se përfshirja e Raportit Marti në “Dokumentet Themelore” të DHSK-së nuk shkel parimin e prezumimit të pafajësisë së z. Thaçi.

58. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Pika VIII, e riformuluar, ndikon ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit gjyqësor. Ajo ndikon ndjeshëm në drejtësinë e procesit duke qenë se ka lidhje me të drejtën e z. Thaçi për t’u prezumuar i pafajshëm, siç parashikohet në nenin 21(3) të Ligjit. Ajo ndikon ndjeshëm edhe në zhvillimin e shpejtë të procesit, sepse Pika VIII, nëse merr zgjidhje në shkallën e apelit, do të shmangte debatet juridike në të ardhmen në lidhje me përfshirjen e Raportit Marti në “Dokumentet Themelore” të DHSK-së dhe do të siguronte që procesi të mos vijojë në prani të shkeljeve të pretenduara të së drejtës së z. Thaçi për t’u prezumuar i pafajshëm. Për këto arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Pika VIII, e riformuluar, ndikon ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, siç parashikohet në nenin 45(2) të Ligjit dhe në rregullën 77(2) të Rregullores.

59. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se zgjidhja e Pikës VIII nga Gjykata e Apelit, ashtu siç është riformuluar, do ta avancojë thelbësisht procesin sepse do të përcaktojë nëse është shkelur parimi i prezumimit të pafajësisë së z. Thaçi, një pikë e cila, nëse nuk zgjidhet, do ta dëmtonte rezultatin e procesit gjyqësor.

60. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Pika VIII, ashtu siç është riformuluar në paragrafin 57, më lart, përmbush standardin e autorizimit dhe autorizon apelimin e Pikës VIII të riformuluar.

8. Pika IX

61. Mbrojtja e Veselit argumenton gjithashtu se Pika IX buron nga mosmarrja vendim nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbi aspektin nëse veçantitë e Ligjit krijojnë një kornizë të ndryshme të së drejtës materiale e cila çon në trajtim të pabarabartë para

Ligjit, në shkelje të Kushtetutës.⁵⁵ Mbrojtja e Veselit argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk shqyrtoi argumentet e saj.⁵⁶

62. ZPS-ja përgjigjet se Pika IX nuk buron nga Vendimi i Kundërshtuar sepse parashtrimet e Mbrojtjes u shqyrtuan në një tjetër vendim të Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe se Mbrojtja e Veselit nuk shpjegon përse kjo pikë duhej të ishte shqyrtuar në Vendimin e Kundërshtuar.⁵⁷ ZPS-ja përgjigjet më tej se Pika IX është duke u shqyrtuar nga Gjykata e Apelit dhe se referimi i dyfishtë i saj nuk do ta avanconte thelbësisht procesin.⁵⁸ ZPS-ja argumenton gjithashtu se parashtrimet e Mbrojtjes së Veselit lidhur me personat që përfshihen në juridiksionin e DHSK-së nuk janë brenda objektit të Pikës IX.⁵⁹

63. Mbrojtja e Veselit kundërpërgjigjet se përfshirja e një të drejte materiale më vete (në formën e Ligjit) është në shkelje të të drejtave kushtetuese të të Akuzuarve duke qenë se në Aktgjykimin e vet nr. KO26/15, Gjykata Kushtetuese e Kosovës nuk ka paraparë që DHSK-ka do të funksiononte në bazë të një të drejte materiale të ndryshme.⁶⁰ Mbrojtja e Veselit argumenton se duhet shqyrtuar nëse Ligji krijon një dallim në trajtim midis z. Veseli dhe personave të tjerë që gjykohen nga gjykata të tjera të Kosovës.⁶¹ Mbrojtja e Veselit argumenton më tej se çdo mbivendosje e mundshme me një pikë që është në shqyrtim e sipër para Gjykatës së Apelit, nuk është vendimtare për rezultatin e kësaj kërkesë.⁶²

64. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Pika IX buron nga Vendimi i Kundërshtuar duke qenë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake bëri një konstatim

⁵⁵ Kërkesa e Veselit, para. 6-7.

⁵⁶ Kërkesa e Veselit, para. 8-10, 12-13.

⁵⁷ Përgjigjja ndaj Kërkesës së Veselit, para. 7.

⁵⁸ Përgjigjja ndaj Kërkesës së Veselit, para. 8.

⁵⁹ Përgjigjja ndaj Kërkesës së Veselit, para. 9.

⁶⁰ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 4-5.

⁶¹ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 6.

⁶² Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 7.

lidhur me të drejtën për të mos u gjykuar nga një gjykatë e jashtëzakonshme dhe ishte në lidhje me këtë aspekt që z. Veseli e kishte përmendur çështjen e pabarazisë sipas ligjit.⁶³ Pika IX ndikon ndjeshëm edhe në drejtësinë e procesit sepse lidhet drejtpërdrejt me të drejtat për gjykim të drejtë të z. Veseli sipas nenit 6(1) të KEDNJ-së. Ajo ndikon ndjeshëm edhe në kryerjen e shpejtë të procesit sepse një zgjidhje në shkallë të apelit e aspektit nëse korniza e së drejtës materiale e DHSK-së e bën të paligjshme DHSK-në në kuptim të nenit 103(7) të Kushtetutës do të shmangte çdo debat juridik në këtë aspekt në të ardhmen dhe do të siguronte që procesi të mos vijojë në shkelje të të drejtave të të Akuzuarve. Për këto arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Pika IX ndikon ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit gjyqësor, siç parashikohet në nenin 45(2) të Ligjit dhe në rregullën 77(2) të Rregullores.

65. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson gjithashtu se një vendim me fuqi detyruese i Panelit të Gjykatës së Apelit lidhur me Pikën IX do ta avanconte thelbësisht procesin sepse do të përcaktonte nëse është shkelur ose jo e drejta e z. Veseli për të mos u gjykuar nga një gjykatë e jashtëzakonshme, një pikë e cila, nëse nuk zgjidhet, do ta dëmtonte rezultatin e procesit gjyqësor.

66. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Pika IX përmbush standardin e autorizimit dhe autorizon apelimin e Pikës IX.

9. Përfundim

67. Në bazë të sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizon Pikën II, Pikën VII dhe Pikën IX, si edhe Pikën V dhe Pikën VIII, siç riformulohen përkatësisht në paragrafët 39 dhe 57, për shqyrtim në shkallën e apelit. Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk autorizon apelimin e Pikës I, Pikës III, Pikës IV dhe Pikës VI.

⁶³ Shih KSC-BC-2020-06, F00224, Mbrojtja e Veselit, *Mocion Paraprak i Mbrojtjes së Kadri Veselit që Kundërshton Juridiksionin mbi bazën e Shkeljeve të Kushtetutës*, 15 mars 2021, publik, para. 6.

V. VENDIM

68. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **MIRATON** Kërkesën e Veselit;
- b) **MIRATON**, pjesërisht, Kërkesën e Thaçit;
- c) **REFUZON** kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për rrëzimin e Përgjigjes ndaj Kërkesës së Thaçit dhe kërkesën e saj për të parashtruar një tjetër kundërpërgjigje;
- d) **AUTORIZON** apelimin e Pikës II, Pikës VII dhe Pikës IX;
- e) **AUTORIZON** apelimin e Pikës V dhe Pikës VIII, siç riformulohen në paragrafët 39 dhe 57, më lart; dhe
- f) **NUK AUTORIZON** apelimin e Pikës I, Pikës III, Pikës IV dhe Pikës VI.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E hënë, 25 tetor 2021

Hagë, Holandë.